




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Procesverbal

Nga seanca e nëntëmbëdhjetë (XIX) e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur, më 24.6.2001 m këtë :

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Shpallja “Qytetar Nderi”, Post Mortum, i intelektualit Beqir Musliu,
2. Projekt Rregullorja për kompensim të pagës për ish zyrtarëve të lartë të komunës,
3. Informatë nga Komisioni për vlerësimin e asteve të KRM “Higjiena” rreth krahasimit të dy formave të PPP në KRM “Higjiena”,
4. Propozim vendimi për dhënien në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta,
5. Propozim vendimi për kompensimin e Komisionit statutar,
6. Propozim vendimi për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë,
7. Propozim vendimi për lirimin nga kompensimi në emër të rregullimit të tokës ndërtimore,

3. Të ndryshme,

Seanca filloi punimet në ora 10.20 min

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e seancës së nëntëmbëdhjetë ishin:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa

Përfaqësuesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal

Përfaqësuesit e OSB-së

Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

Mysafirët nga Republika e Shqipërisë

Mediet

Seancën e nëntëmbëdhjetë e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti fillimisht mysafirët nga Shqipëria prof. dr Josif Papagjonin, dramaturg dhe mr.Eremestina Halili dramaturge, por përshëndesim në mënyrë të veçantë bashkëshorten e Beqir Musliut znj. Ismete Musliun.

Përshëndes OJQ- të, të cilat marrin pjesë në këtë Seancë, mediet e shkruara dhe elektronike dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Pushteti Lokal të cilët po e monitorojnë gjithherë punën e KK-së.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në këtë seancë mungojnë: Jashar Jashari dhe Enver Hajrullahu.

Izmi Zeka - mund të vazhdojmë me punë, sepse ka kuorum të mjaftueshëm, prandaj propozoj që të deklaroheni se kush është që të vazhdojmë me këtë rend pune?

Sokol Haziri- pajtohem me rendin e ditës ashtu si jemi marrë vesh në Komitetin për Politikë dhe Financa, por ne jemi dakorduar që një deklaratë ta japim për një gjykim të drejtë të z. Haradinaj.

Izmi Zeka- materialin e keni për këtë dhe nëse keni vërejtje mund të jepni kur të vijë në rend të ditës kjo pikë

Izmi Zeka- ju lutem që të deklaroheni për rendin e punës me plotësim të deklaratës për mbështetje për z. Haradinaj ?

Aprovohet rendi i punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Procesverbali-

Selim Selimi- në procesverbal f.23 është thënë se TIK-a Turke është OJQ, ajo është organizatë qeveritare jo OJQ.

Aprovohet procesverbali me këtë përmirësim

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Shpallja “Qytetar Nderi”, Post Mortum, i intelektualit Beqir Musliu, Izmi Zeka – ju e keni materialin të kompletuar për këtë pikë të rendit të punës, por për neve në Gjilan Beqir Musliu është një njeri me renome dhe shumë i njohur si njeri i letrave dhe shkrimeve nga zhanret e ndryshme të letërsisë.

Beqir Musliu ka qenë njeri i metaforës i cili ka pasur një stil të veçantë, i cili stil është i rrallë në letërsinë shqiptare edhe në Kosovë, por edhe jashtë Kosovës.

Për Gjilanin është krenari e madhe që e patëm një shkrimtar të tillë, por fatkeqësisht vdekja e mori herët.

Mirëpo ai përsëri na ka lënë një volum të madh të librave, por sipas informatave që posedojmë Beqa ka lënë edhe dorëshkrime. Ne si gjilanas do të interesohemi për ato

dorëshkrime dhe do të mundohemi që të shohin dritën ato dorëshkrime dhe të pasurohet edhe më tepër krijimtaria e Beqir Musliut.

Në fund po e them se ishte vullneti i të gjithë këshilltarëve komunal, i kryetarit të Komunës për ta shpallur këtë krijues Qytetar Nderi (Post mortum).

Kërkoj për aspekt teknik që të deklaroheni se kush është për atë që Beqir Musliu të shpallet Qytetar Nderi i Komunës së Gjilanit (Post mortum).

Me vota unanime dhe me duartrokitje aprovohet pika 1 e rendit të punës që të shpallet “Qytetar Nderi” Post Mortum intelektual, Beqir Musliu

Në vijim vazhdon procedura e dhënies së Mirënjohjes, të cilën e jep kryetari i Komunës, zonjës Ismete Musliu, bashkëshortes së Beqir Musliut i cili akt u përcoll me duartrokitje nga ana e të pranishmëve në sallë.

Izmi zeka – tani fjalën do ta ketë kryetari i Komunës

Qemajl Mustafa- përshëndetje për këshilltarët komunal, për krijuesit letrat, për kritikët dhe në përgjithësi për dashamirët e artit, por në mënyrë të veçantë e përshëndesim familjen (bashkëshorten) e Beqir Musliut.

Unë iu falënderoj në emër timin personal në cilësinë e kryetarit të Komunës dhe të gjithë qytetarëve të Komunës sonë.

Së pari falënderojmë të gjithë dëshmorët e kombit të cilët na nderuan të cilët na e kthyen dinjitetin dhe u bënë gurthemel në krijimin e lirisë dhe shtetit të Kosovës që të punojmë lirshëm dhe që të vijmë edhe tek ky moment i kësaj natyre kur mund të shpallim edhe qytetarë nderi, qytetarë tanë, por edhe të tjerë jashtë Komunës.

Më lejoni që një urim të veçantë t’ia adresoj krijuesit të veçantë, Beqir Musliut i cili me punën dhe veprën e tij aq shumë na nderoi neve si Komunë, por edhe si regjion edhe si komb. Gjithashtu një falënderim të veçantë për studiuesit dhe kritikët që dje mundësuan ta shpalosim jetën dhe veprën e Beqir Musliut e që në fakt e kanë përkrah derisa Beqiri ishte gjallë dhe vepronte të cilin e kanë vlerësuar, por edhe të cilët vazhdojnë për ta konsumuar veprën e Beqir Musliut. Fal këtij përkushtimi ne vlerësuam që Beqir Musliu duhet të rangohet lartë në vlerat e artit të letërsisë.

E falënderojmë DKRS-në për një përkushtim dhe AS Klubit “Beqir Musliu”, por sidomos bartësve të punës rreth këtij shënimi të këtij 15 vjetori të vdekjes së këtij krijuesi tonë e që janë z. Sabit Rrushemi, z. Tahir Arifi dhe zonja Enkelejdë Arifi.

Është thënë shumë çka për punën dhe veprën e palodhshme të Beqir Musliut e sidomos dje në një simpozium për jetën dhe veprën e Beqir Musliut.

Ne jemi sot këtu që ta shpallim qytetar nderi një njeri të merituar siç është Beqir Musliu. Ta shprehim mirënjohjen, time të thellë për jetën dhe veprën që na nderoi me trashëgimi të pavdekshme krijuese. Mua më ra hise që në cilësinë e kryetarit të Komunës, ta shpallim qytetarin e dytë të nderit për këto 11 vjet të punës së këtij Kuvendi në liri dhe demokraci. Po e bëjmë këtë për një njeri i cili e nderoi veten, familjen e tij dhe neve, sepse tash më e kemi pasuri veprën e tij dhe po e bëjmë këtë për Beqir Musliun tonë të nderuar, por e bëjmë këtë për respektin tonë dhe vlerave tona, por këtë do të vazhdojmë ta bëjmë edhe për të tjerët të cilët i kanë hap rrugë lirisë.

Vepra e Beqir Musliut ende nuk është kompletuar, por unë si kryetar i Komunës, jam zotuar se do të përpiqem që kjo vepër të kompletohet , për ta bërë të tërësishme, për ta

sistemuar dhe çështjes së veprës së Beqës t'i japim fund dhe ajo të jetë përgjithmonë në duar të lexuesve.

Në fund urime familjes, sidomos urime Kuvendit dhe dëshirojmë që qytetarët e Komunës së Gjilanit ta mbajnë me nder dhe ta respektojnë.

Fjala e kryetarit u mbyll me duartrokitje.

Izmi Zeka- për një fjalë përshëndetëse e thërret zonjën e Beqir Muslit, Ismete Musliun.

Ismete Musliu- iu falënderoj juve këshilltarëve, kryetarin e Komunës dhe të gjithëve

Izmi Zeka- faleminderit, juve këshilltarë, faleminderit familje, vepra e Beqir Musliut, është dhe do të jetë e pavdekshme, ajo do të jetë përherë në mesin tonë.

Kryesuesi i Kuvendit, pas këtij akti solemn, kërkon 5 minuta pushim.

Pa pesë minutave pushim fillon seanca dhe kryesuesi para së të fillojë me pikën e dytë të rendit të punës kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të respektohet me një minutë heshtje deputetja e Kuvendit të Kosovës, zonja Nekibe Kelmendi e cila ndërroi jetë para pak ditës.

Në respekt të zonjës Nekibe Kelmendi të gjithë pranishmit në sallë e nderuan të ndjerën me një minutë heshtje

2. Projekt Rregullorja për kompensim të pagës për ish zyrtarëve të lartë të Komunës,

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi ia jep fjalën, kryetarit të Komisionit statutar dhe menaxherit të zyrës ligjore z. Hevzi Matoshi i cili do ta jep arsyetimin përkitazi me propozimin për miratim të kësaj rregullore.

Hevzi Matoshi- arsyetimin e tij z. Matshi e arsyetoi para anëtarëve të Kuvendit për këtë rregullore dhe theksoi :

I nderuari,

- Kryetar i Komunës,
- Kryesues i Kuvendit të Komunës dhe
- Anëtarë të KK-së.

Duke u bazuar në autorizimet që ka marrë komisioni për çështje statutare dhe akte tjera, ka hartuar projektin e rregullores për kompensimin e pagës për ish zyrtarë të lartë të komunës të cilët nuk ushtrojnë funksion publik.

Duke u bazuar në rrethanat të cilat kanë ndikuar që të kemi një akt të tillë me të cilin do të rregullohet çështja e kompensimit të pagës për ish zyrtar të lartë të komunës të cilët kanë qenë të zgjedhur ose të emëruar dhe me skadimin e mandatit të tyre nuk janë sistemuar është propozuar nga komisioni që këtë statut ta gëzojnë:

- Kryetari i Komunës,
- Nënkryetari i komunës,
- Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe
- Anëtarët e KK-së.

Në Komitetin për Politikë dhe Financa është propozuar që këtë të drejtë ta gëzojë edhe ish Kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës.

Sipas këtij projekti kompensimi i pagës do të jetë 70% të pagës bazë për Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e komunës, Kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin e KK-së, kurse për anëtarët e KK-së në kompensimin e pagës për bazë merren edhe kompensimet tjera që i ka realizuar anëtari i KK-së.

Në rast se ky projekt merr vizën nga Kuvendi për miratim, atëherë i njëjti do të jetë në fuqi që nga data 01 janar 2012, kuptohet paraprakisht duhet të ndahen mjete buxhetore për këtë çështje. Në rast se mjetet nuk ndahen atëherë nuk mund të pritët që ky akt të jetë i zbatueshëm.

Arben Mehmeti- unë jam edhe anëtar i komisionit për hartimin e kësaj rregulloreje, por disa propozime që u përmenden këtu duhet të rishikohen dhe të mos aprovohen, për atë se në këtë rregullore nuk duhet të përfshihen edhe drejtorët e drejtorive, për atë se dihet se në çfarë pozicioni janë drejtorët! Ne në parim nuk jemi kundër, por është diçka e cila nuk mund të realizohet dhe ka mundësi që kjo të mos zbatohet në praktikë.

Mendoj se duhet të dallohen pozicionet e lartë prej atyre të këshilltarëve, prej kryetarit e kështu me radhë. Këta të cilët janë propozuar këtu janë njerëz të zgjedhur nga qytetarët dhe organet e ndryshme komunale. Unë e kam një propozim të cilin e pata propozuar dhe në komision, ku nuk kam hasur në përkrahje, prandaj po e propozoj këtu, e ky propozim sipas këtij drafti është një vit, kurse unë propozoj që të jetë tri vjet, kurse pesë vjet të jetë për kryetarin e Komunës dhe për kryesues.

Do të thotë 3 vjet për një pjesë të këtyre kategorive, kurse 5 vjet për kryetarin e Komunës dhe për kryesuesin. Këto janë propozimet tona të cilat ne i mbështesim në parim.

Zijadin Maliqi- neni 2 i rregullores sqaron se kush janë zyrtarët e lartë të Komunës, mirëpo në nenin 5, mungon kryeshefi i ekzekutivit edhe pse përmendet në nenin 2.

Unë mendoj se ajo çka është paraparë në nenin 2 duhet të përfshihet edhe në nenin 5.

Duhet të harmonizohen këto dy nene.

Qemajl Mustafa- mua më pëlqeu propozimi i Arbenit, sepse kjo po i bie si ndonjë ndihmë ad-hok dhe si një lloj lëmoshe, propozimi (deri në një vjet).

Mendoj se ka plotë njerëz të dinjitetshëm që do të heqin dorë dhe është mirë që ishte një fjali në rregullore që kanë të drejtë të heqin dorë.

Është një qasje shumë lëmoshare, një vjet, por ajo 3 vjet e katër po, por duhet të thuhet brenda një mandati, sepse kështu hiqet obligimi me ata që kanë qenë këshilltarë nëse kanë mbet si të tillë. Mandej kjo rregullore merret me ata që janë në mandatin aktual dhe mua më pëlqeu një rezon i asaj natyre dhe ndoshta do të duhej rregullorja ashtu të plotësohet.

Tjetra është me disa kufizime dhe e kam thënë se nuk po pajtohem me disa gjëra si: nëse drejtorët i cili është post shumë i lartë dhe ata që e bëjnë jetën institucionale të Komunës 24 orë në ditë gjatë gjithë mandatit janë drejtorët bashkë me ne të tjerët.

Drejtorët janë ministra në nivel lokal, janë të besueshmit e kryetarit të Komunës dhe është delegim i besimit për lëmit e caktuara, sikurse mandatarin në Qeverinë e Kosovës i cili e ka mandatin kushtetues dhe të drejtën kushtetuese për të deleguar besim te

ministrat. Prandaj edhe drejtorët janë të emëruar politikisht dhe të ardhur politikisht, sepse vijnë nga fuqia e kryetarit të Komunës.

Unë do të kisha propozuar që të jenë aty edhe drejtorët, sepse nuk besoj se numri i atyre që do të mbesin keq do të jetë i madh, me një kufizim që do të vlejë edhe tek kryetari, te këshilltarët, kryesuesi dhe drejtorët. Nëse nuk është shkarkuar në ndërkohë, nuk ka bërë ndonjë ekces, por të jetë edhe më rreptë, nëse një gjysmë mandati ka shërbyer në Kuvend, kurse drejtorët duhet ta shtjerrin mandatin për t' u sanksionuar me këtë rregullore. Ky është rezoni im dhe nuk do të thotë se ju do ta miratoni, por megjithatë disa kufizime nevojiten, sepse dikush mund të heq dorë nga posti i kryetarit, ose nga pozita e këshilltarit të Kuvendit.

Ejup Haziri- ne si grup ishim në pajtim edhe me variantin e parë si ka qenë. Mirëpo propozimin që e dha shefi i grupit të LDK-së nuk është propozim i keq. Unë jam që të gjendet një kompromis në mes propozimit që e dha kryetari i Komunës dhe atë që e dha shefi i grupit të LDK-së, z. Mehmeti.

Arben Maliqi- unë së pari e uroi kryetarin dhe kryesuesin për faktin se po e shpallim Qytetar Nderi, shkrimtarin tonë të njohur Beqir Musliun. Kjo është një arritje e madhe për ne dhe duhet të mburremi me atë që e patëm një njeri si Beqir Musliun.

Ne në parim jemi për ta mbështetur këtë rregullore dhe jemi që të kalojë edhe në këtë variantin e dytë. Ne jemi një grup dhe drejtorët janë pjesë e jona dhe e përkrahim.

Elisah Ymeri- unë kam vërejtje tek nenin 1.3, sepse nuk është e precizuar mirë, sepse mund të ketë burime, por ato mund të jenë shumë të vogla dhe unë kisha kërkuar që fjalia: “nuk ka burime për jetë” ashtu si është në këtë nen të hiqet.

Arben Mehmeti- ne qëndrojmë prapa asaj që e tha kryetari dhe nëse jeni në dijeni, është një vendim që ka marrë ky Kuvend që ish drejtorëve të drejtorive t' iu mundësohet sistemimi nëpër vende të punës në çastin që i kalon mandati. Ne këtë e kemi pasur parasysh edhe në komision dhe atë privilegj drejtorët aktual e kanë. Kjo është arsyeje pse nuk i kemi planifikuar drejtorët, kurse zyrtarët dhe këshilltarët nuk janë përfshirë në këtë mënyrë dhe kjo është një dallim dhe dallojnë shumë pozicionet e kësaj kategorie me drejtorët. Ju e dini që drejtor mund të jetë një orë, por pas një ore mund të mos jetë drejtor. Këshilltarë komunal është më problematike, kryetar Komune dhe kryesues gjithashtu. Ne duhet shikuar gjërat si është realiteti dhe kryetari e tha mirë që duhet të përfshihet edhe ajo që mbi gjysmën e mandatit të jetë në kuadër të rregullores.

Riad Rashiti- unë pajtohem me ato që u thanë me përjashtim të asaj që është edhe kryeshefi ekzekutiv, prandaj nuk jam që të futet edhe pozicioni si është kryeshefi ekzekutiv, sepse që katër vjet ai post nuk ekziston në institucionet tona. Mendoj se nuk duhet të kthehemi retroaktivisht dhe t' i stimulojmë pozicionet të cilat nuk ekzistojnë.

Ibish Ibishi- lidhur me këtë pikë pat shumë vërejtje, vërejtjet e z. Arbenit ishin të qëndrueshme, por dhe vërejtja e Riadit më pëlqeu shumë, sepse që disa vite e kemi pasur një pozicion të shefit ekzekutiv, por ai tash nuk ekziston. Ne në parim do ta përkrahim këtë rregullore, por vërejtjet që u dhanë duhet të merren parasysh.

Izmi Zeka- po shihet se ka një koncenues, por me këto vërejte të merret Zyra ligjore, ta rregullojë nenin 3, 5, të jetë për këshilltarët komunal, drejtorët le të hyjnë, sepse vendimi është për t' i gjetur vende të punës.

Për kryeshefin nuk jam as unë, sepse ka kaluar kohë, prandaj duhet të fillojmë prej pozicioneve të tashme.

Vërejtjen që e bëri Elisau ishte me të drejtë e cila duhet të hyjë në rregullore.

Të përfshihet edhe propozimi i kryetarit, për drejtorë të jetë 4 vjet, (të mbyllet mandati), por për këshilltarët të vlejë, gjysma e më tepër e mandatit.

Jakup Bajrami- lidhur me kryeshefin e kemi debatuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe konstatuam se ky pozicion tash e ka tretmanin krejt tjetër dhe me një farë forme derisa nuk është aprovuar Ligji për pushtetin lokal ky ka qenë një vend me shumë rëndësi dhe ka pasur tretmanin e një personaliteti publik.

Mirëpo mos të keqkuptohem, sepse personi në fjalë që e ka mbajtur këtë post deri më sot askush nuk e ka ftuar dhe nuk i ka ofruar vend të punës. Ky vend ka mbet i patrajtuar, prandaj unë mendoj se duhet të trajtohet si të gjithë të tjerët, derisa të refuzohet nga ky person apo derisa të kemi ndonjë argument për ta demantuar këtë që po them.

Izmi Zeka- lidhur me këtë unë po pyes si do të veprojmë ne me drejtorët që nga pas lufta e këndeje? Ka plotë drejtorë të tillë, të cilët janë të pa punë. Ne rregulloren po e nxjerrim tash, prandaj ne nuk mund të kthehemi prapa.

Rregullorja hynë në fuqi për këtë legjislaturë e këndeje, por iu lus mos të keqkuptohemi, sepse askush nuk ka asgjë ndaj askujt.

Sadudin Berisha- kjo është një çështje shumë e ndjeshme të diskutohet për te dhe opinionin publik po të dëgjoj, fiton një përshtypje se njerëzit po punojnë vetëm për gjëra personale, për ata që janë në funksione politike dhe publike.

Në momentin kur është iniciuar kjo çështje ne e kemi mbështet si rast i cili na ka detyruar, sepse ishte rasti i vdekjes së papritur të ish kryetarit të Komunës z. Xhemajl Hyseni. Çështjet të cilat u shtruan këtu kemi arritur me komisionin për ndryshimin e akteve të ndryshme nën ligjore t' i harmonizojmë duke mos u zgjeruar skajshmërisht në të drejtat dhe në ato të cilat do të mund t' i kishte një i zgjedhur i qytetarëve të Komunës. Pat shumë propozime të ndryshme deri në propozimin e rritjeve për të drejtën e kompensimit me qëllimin më të mirë që mos të mbetët në mëshirën e askujt tjetër, por të ketë një përgjegjësi institucioni.

Nëse kemi propozime të shumta, unë kujtoj se kjo rregullore duhet t' i rikthehet komisionit me të gjitha këto debate të cilat u bënë këtu, të rishikohet, të bëhen ndalesat të cilat reflektojnë të një kategorie të cilat formalisht e kanë të drejtën.

Ne ekskluzivisht këtë e kemi orientuar për një kategori të caktuar deri në një vit dhe nëse KK- nuk arrin brenda një viti për t' i sistemuar apo të zgjidhe problemi i tyre, atëherë as dy vite as tri nuk mund të bëjë zgjidhje të qëndrueshme.

Propozimi im është personal që të rikthehet edhe njëherë në Komision të rishikohen të gjitha ato propozime dhe të shikohet edhe mundësia buxhetore.

Ne nuk mund të nxjerrim një rregullore për këtë legjislaturë, duke i përjashtuar legjislaturat tjera, në mënyrë se si u debatua.

Qemajl Mustafa- është një e vërtetë të cilën unë e kam thënë në këtë Kuvend që komitetet pata folur për komitetet, por edhe komisionet nuk po e bëjnë qasjen e përkushtuar për të dal produkti mirë. Ne i kemi pasur njerëzit në komisione, i tërë spektri politik është i përfaqësuar, prandaj do të duhet të identifikohemi me këshilltarin, punëtorin, kryesuesin dhe kështu del rregullorja e mirë. Zyra ligjore nuk është ajo e cila ka dëshmuar që din për të bërë rregullore të mira. Ne jemi ata të cilët do të duhej t' i ndihmojmë asaj zyre.

Zyra do të duhej të ishte më tepër një formulues juridik e normalizues teknik i atyre akteve, këtë po e them me keqardhje, por kjo është kështu!

Unë jam për ta kthyer, sepse nuk po ik koha, por mos të merret me ankth kjo punë, por nëse dëshironi të jetë edhe për ata të mandatit të kaluar të cilët nuk e kanë problemin e zgjidhur. Në këtë formë do ta shohim se numri i atyre që mbesin keq do të jetë simbolik dhe nuk do të ngarkohet buxheti i Komunës. Këtë duhet shumë mirë të përkufizohet dhe të thuhet nëse gjendja e familjes së personit në fjalë nuk është e kënaqshme. Rregullorja duhet të përpilohet me saktësi.

Shkëlqim Latifi- unë kam vërejtje në atë ku u përmend kufizimi i mandatit 2 vjet, unë mendoj se vdekja është e natyrshme, prandaj një këshilltarë mund të vdes tri ditë për pa i mbushur 2 dhe mos ta gëzojë këtë të drejtë për mua është e pa arsyeshme.

Elisah Ymeri- unë mendoj se çdo rregullore, kur miratohet ajo miratohet nga ajo ditë dhe nëse ne e bëjmë Kuvendin fontan dëshirash nuk e kam të qartë pse po vijmë këtu.

Rregullorja është sjell, komiteti e ka miratuar është sjell në Kuvend, kurse ne duhet ta miratojmë dhe jo ta kthejmë dhe mos të merremi dy herë me një çështje të pakuptimtë.

Arben Maliqi- duhet ta kemi të qartë, jo njëherë e dy, por dhjetë herë nëse është nevoja i kthejmë. Është mirë që kur t' i marrim vendimet në Kuvend, ato të jenë si duhet.

Unë personalisht jam për ta kthyer, sepse këtu nuk është diçka në rregull. Duhet të definohen mirë gjërat për çdo nen saktë dhe mos të dalim me vendime paushalle.

Unë jam i mendimit se më mirë është që të vonohet dhe të bëhet si duhet dhe jo të bëhet shkel e shko.

Elez Muja- unë po pajtohem me shumë parafolës, por kur po flet kryetari plotësisht po ma mbush mendjen dhe po bindem në atë që po e thotë. Mirëpo te neni 2 përfshihet kryeshefi i ekzekutivit, kurse në nenin 5 nuk përfshihet! Këtu në rregullore në një mënyrë po mbetet një hapësirë për manipulim

Në anën tjetër thuhet zyrtarë të lartë të cilët me siguri janë të mandatit të kaluar, atëherë edhe kryeshefi është nga mandati i kaluar dhe nëse zgjat një vit, atëherë edhe për kryeshefin të jetë një vit. Kryeshefi ka qenë në atë pozitë jo një mandat, por dy mandate dhe nëse zgjatë një vjet për të tjerët të zgjat edhe për atë. Ai është i pa punë, do të thotë është i larguar nga puna, ky post ka ekzistuar edhe nëse epet për të kaluarën të përfshihet edhe ky post. Këtu po shihet qartë se ka hapësirë për manovrim, sepse në nenin 2 përfshihet kryeshefi, kurse në nenin 5 jo!

Izmi Zeka- unë propozoj që ta rikthejmë, por me një propozim që unë nuk jam për atë që ata zyrtarë të cilët kanë qenë më herët, me një rregullore e cila nxirret tash t' i gëzojnë këto benificione! Nuk mund të kthemi që nga viti 2000, sepse kjo nuk

funksionon. Rregullorja nxirret për këtë mandat dhe po i drejtohem edhe Zyrës ligjore që të përfshihen edhe drejtorët dhe konsultoni mirë me komisionin dhe mos të vijë komisioni për të bërë vërejtje këtu.

E rikthejmë edhe njëherë dhe në seancën e ardhme të na sillet me këto vërejtje që u bën!

Ejup Haziri- ne grupi këshilltarëve e kemi përkrah si ka qenë parimisht, sot nuk ka faj Zyra ligjore, sot kemi faj ne që hymë në procedura e zgjatëm, por edhe komisioni e zgjati dhe me të vërtetë u lëshuam në një debat fontan dëshirash. Unë e thash me qëllimin më të mirë që në mes dy propozimeve që ishin të gjendet një mes, do të thotë në mes propozimit të Arbenit dhe kryetarit të Komunës.

Ne jemi që të kthehet tash prapa të formulohet mirë, mirëpo po e them se nuk ka faj dikush tjetër, faji sot është i yni.

Qemajl Mustafa- nuk mjafton vetëm të kalojë në grupet e këshilltarëve, por duhet të kalojë mirë ashtu si duhet. Ju nuk jeni ndal për të bërë analizë, nuk jeni ndal për të parë aspektin praktik të funksionimit të kësaj rregulloreje. Si funksionon kjo në praktikë dhe cilët janë individët meritore të cilët duhet të sanksionohen me këtë rregullore?

Drejtorët janë ata të cilët në të gjitha mandatet dhe pas çdo mandati, një pjesë e drejtorëve na ka mbet pa punë! Mirëpo prapë do të ndodhin gjëra të tilla, sepse me automatizëm nuk do të kemi mundësi, ditën e nesërme kur përfundon mandati t' i sistemojmë të gjithë drejtorët. Ndonjë muaj shumë drejtorë do të mbesin pa të ardhura dhe atë vakum kjo rregullore e plotëson.

Izmi Zeka- kush është që kjo rregullore t' i rikthehet edhe njëherë Komisionit për ndryshime statutare?

Me vendim unanim të anëtarëve të Kuvendit pika 2 e rendit të punës: projekt Rregullorja për kompensim të pagës për ish zyrtarëve të lartë të Komunës i rikthehet komisionit për ndryshime statutare.

Izmi Zeka – është mirë edhe pika 5 e rendit të ditës: vendimi për kompensim të komisionit Statuar, të rikthehet, sepse duhet definuar dhe disa gjëra të cilat janë të pa qarta dhe propozimet janë të larta.

Kush është që të kthehet dhe rishikohet?

Me aprovim unanim të anëtarëve të Kuvendit edhe pika 5 e rendit të ditës : propozimi –vendimi për kompensimin e Komisionit statutar shtyhet për seancën e ardhme.

3. Informatë nga Komisioni për vlerësimin e asteve të KRM “Higjiena” rreth krahasimit të dy formave të PPP në KRM “Higjiena”,

Izmi Zeka- kjo çështje është shqyrtuar në komitet, kurse një informatë do ta jep kryetari i këtij komisioni z. Rida Rashiti.

Izmi Zeka kjo informatë është shqyrtuar në komitet, kurse tash atë informatë do ta jep z. Riad Rashiti.

Riad Rashiti- lidhur me këtë pikë, z. Rashti e informoi Kuvendin në detale, por kjo informatë u dorëzua me shkrim në sekretari e cila do t' i bashkëngjitet procesverbalit.

4 .Propozim vendimi për dhënien në menaxhim të vend gjuetive të përbashkëta,

Izmi Zeka- jeni të njohur se kjo pikë e rendit të punës ka qenë njëherë në Kuvend, të cilën ia kemi kthyer drejtorisë dhe ka qenë një komision prej anëtarëve i cili komision e ka bërë punën vetë të cilën përsëri e ka kthyer në KK.

Jam i mendimit se tash procedurat janë zbatuar sipas rregullave, por fjalën do ta ketë Arben Maliqi, kryetari i këtij komisioni i cili do të na informojë më detalisht.

Arben Maliqi- në bazë të vendimit të KK-së të datës 9.3.2011, Kuvendi ka zgjedh një komision për ndarjen e vend gjuetive të përbashkëta i cili komision përbëhet prej tre anëtarëve. Si anëtarë jam unë, por edhe kryesues dhe jam nga koalicioni, pastaj nga LDK është z. Ramiz Ramdani dhe drejtori i drejtorisë, z. Nami Rapuca.

Komisioni e ka marrë këtë vendim dhe e legjitimon vendimin e drejtorisë edhe atë vend gjuetia “Karadaku” me sipërfaqe prej 8.904 h i epet Shoqatës së Gjuetarëve “Agim Ramadani”, vend gjuetia e përbashkët “Zhegoc” i epet në menaxhim Shoqatës së Gjuetarëve “Ujku” në sipërfaqe prej 15.324 h dhe vend gjuetia “Maja e Gjelbër” në sipërfaqe prej 16.680 h i epet në menaxhim Shoqatës së Gjuetarëve “Petriri”

Pas takimeve të shumta të komisionit dhe përfaqësuesve të shoqatave të gjuetarëve të cilat veprojnë në Komunën e Gjilanit u arrit në këto kompromise: nëse Komuna e Parteshit themelon shoqatë të gjuetarëve dhe dëshiron t' i bashkëngjitet një vend gjuetie të caktuar, atëherë territori i Komunës së Parteshit i takon asaj vend gjuetie. Nën dy: territori i cili i merret njëres nga shoqatave i kompensohet nga vend gjuetia që i merret nëse cenohet ekzistimi i vend gjuetisë.

Dhe tre: komisioni do ta shqyrtojë ndarjen e vend gjuetive nëse për arsye të ndryshme rrezikohet ekzistenca e ndonjë vend gjuetie.

Në fund duhet të them se duhet t' i përshëndesim kryetarët e këtyre shoqatave të cilët shprehen një gatishmëri dhe patën një koncenzues për këtë çështje.

Unë kërkoj nga KK- që ta miratojë këtë propozim.

Tahir Arifi- mua më kujtohet se kur kemi biseduar për këtë pikë herën e fundit në këtë Kuvend, unë dhe dy të tjerë kemi qenë kundër shtyrjes. Mirëpo nga ajo që e tha z. Maliqi, po e shoh se po përsëritet ajo cila e kemi debatuar më parë, nëse e kam gabim le të më përmirësojnë z. Maliqi dhe drejtori. Desha të them vetëm këtë se kështu ne i përsërisim dhe e emitojmë veten dhe kështu i marrim kohë vetës dhe nuk bëjmë asgjë tjetër dhe ia vështirësojmë punët njerëzve të cilët e kryejnë punën e tyre.

Ramiz Ramadani- patjetër duhet t' i përgjigjem z. Tahitit, sepse jam i bindur se nuk është ashtu! Konsideroj se komisioni e ka kryer punën jashtëzakonisht sinqerisht dhe ka qenë i përgjegjshëm, por të përgjegjshëm kanë qenë edhe kryetarët e shoqatave.

Mirëpo atë që e kemi bërë ne si komision është se kemi kthyer ligjshmërinë në vend, sepse nuk është përfill ligji në kohën kur kjo çështje ka ardh në Kuvend! Ne e kemi rikthyer në procedurë dhe nuk kemi vepruar as me teke as me inate, por si komisioni kemi desh që të jemi racional. Vërtetë e kemi respektuar edhe drejtorin e drejtorisë për të

cilin nuk e kemi pasur asnjë vërejtje, kurse ne si komision e kemi kryer punën me dy procedura shumë të rëndësishme si: e para komisioni nuk lejoi zhbërjen e vend gjuetive, e cila gjë është shumë e rëndësishme, sepse një shoqatë nëse merr 20% humb më shumë, një territor ajo nuk ekziston. Ne e kemi saktësuar, definuar me pëlqim të gjithë shoqatave dhe mendoj se kjo është e arritur jashtëzakonisht e madhe. Gjithçka që kemi bërë ka qenë në interes të shoqatave, sepse është një akt delikat dhe çdo gabim i komisionit do të ishte reflektuar në terren.

Riad Rashiti- këtu në një anë po thuhet se është respektuar puna e drejtorisë, unë mendoj se së pari komisioni i cili është formuar nga Kuvendi nuk ka të drejtë të marrë vendim! Komisioni e ka të drejtën të sjell propozime këtu për t' i aprovuar, kurse për legjimitet, Kuvendi e ka atë të drejtë. Duhet respektuar ligjshmëria, por unë po e shoh se vetëm një faqe është nga puna e komisionit dhe nuk po e shoh asnjë procedurë e cila është përsërit dhe asnjë përmirësim. Unë e mbështesë këtë, por me një kusht që kjo të jetë njëvjeçare dhe kjo të futet në këtë vendim dhe atë që në vitin e ardhshëm sinqerisht të respektohet prej fillimit ligji për gjueti dhe rregulloret e KK-së.

Qemajl Mustafa- komisioni e ka rishqyrtuar punën e drejtorisë dhe ka konstatuar se drejtori ka punuar mirë, por me një tejkallim procedural. Me ligj duhet të merret qëndrimi në Kuvend e pastaj të shpallet tenderi. Kjo nuk është bërë atëherë, prandaj ne e kthyem për të marrë një besim politik, koncenzues nga të gjithë.

Ky komision i ka pasur dy role jashtëzakonisht pozitive. Një për ta rishqyrtuar punën e drejtorisë në këtë çështje nga fillimi deri në fund dhe e dyta për ta arrit një pajtueshmëri politike e cila në fakt është arrit.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesi i Kuvendit kërkon që të aprovohet kjo rregullore?

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 4 e rendit të punës:
Propozim vendimi për dhënien në menaxhim të vend gjuetive të përbashkëta,

5. Propozim vendimi për kompensimin e Komisionit statutar,

Me propozim të kryesuesit të Kuvendit dhe me aprovim të anëtarëve të Kuvendit, pika 5 e rendit të punës shtyhet për seancën tjetër

6. Propozim vendimi për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë,

Izmi Zeka- kjo çështje është debatuar disa herë dhe në materialet e juaja i keni edhe kriteret dhe modalitetet për këto kufizime të mbeturinave dhe të ujit.

E keni edhe një listë të qytetarëve të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj Hidromoravës. Pas analizave që ne i kemi bërë kemi ardh në përfundime se këto kriteret duhet të kalojnë në KK. Paraprakisht po theksoj se nuk kemi arrit në ujdi me shefat e grupeve në këtë pikë, por sidomos sa i përket ujit. Kjo çështje është zhagit mjaft, prandaj sot është momenti i fundit për t' i dhënë vizën kësaj çështje dhe të përmbyllet ky aspekt.

Mirëpo ka pasur edhe dezinformata se gjëja unë jam kërcënuar me prishje të koalicionit nëse ky propozim nuk votohet, gjë e cila nuk qëndron për asnjë çast.

Unë përfundimisht kërkoj nga anëtarët e Kuvendit, që ta kalojmë këtë çështje me koncenzues në mënyrë që të ecim përpara me punë të tjera në këto kompani.

Unë e kam thënë edhe më herët se këto të mira i kthehen qytetarëve, kurse qytetarët kanë për obligim t' i kryejnë obligimet ndaj këtyre dy kompanive.

Nëse duam ta lëmë gjendjen kështu atëherë duhet ta dimë se nuk do të ketë investime, nuk do të ketë projekte sa i përket Hidromoravës. Nuk mund të ankohemi pse nuk mbërrin ujë në këtë apo atë lagje. Nëse e aprovojmë këtë vendim, ne e ndihmojmë veten, por edhe kërkojmë llogari prej të dy kompanive, prandaj iu lus që këtë çështje ta kalomë me koncenzues.

Sokol Haziri- ne e kemi bërë publik qëndrimin tonë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, por dua ta përsëris të njëjtin edhe në asamble. AAK është kundër një vendimi të tillë për shumë arsye. Arsyeja e parë është se ne si KK- nuk kemi asnjë ingerencë në kuptim të menaxhimit në Kompaninë e Ujërave "Hidromorava", kurse e dyta ne do të kishim pasur dhjetëra mundësi të tjera për ta ndihmuar nëse ka nevojë. Unë konsideroj se ndihmën më të mirë do ta bëjmë nëse punojnë me përkushtim për t' i realizuar objektivat e tyre. Sa i përket Kompanisë së Mbeturinave "Higjiena" ne do të kishim gjet ndonjë formë të mbështetjes, por ajo është në një proces të tranzicionit të pa përfunduar dhe unë mendoj se kjo pikë duhet të shtyhet deri në rregullimin e statusit përfundimtar të kësaj kompanie. Sidoqoftë unë po e marrë një shembull, ne po flasim për ata që nuk e bëjnë pagesën e ujit, por po e harrojmë një fakt se për të realizuar një të drejtë që të shprehen taksativisht në këtë propozim, çdo qytetarë duhet të shkojë te sportelet e dy kompanive për të marrë një vërtetim se është paguesi i rregullt.

Unë jam i mendimit që ta shtyjme këtë çështje të hulumtojmë mundësi të tjera dhe mos të shkojmë në atë drejtim që kjo çështje të jetë objekt i Gjykatës Kushtetuese.

Ne në asnjë mënyrë nuk dëshirojmë të bëhemi servis i menaxhmenteve që shpeshherë kujdeset vetëm për vete dhe jo për kompanitë e tyre. E di që ka mungesë të investimeve, e di që ka vështirësi në realizim të këtyre objektivave, por sidoqoftë është përgjegjësi e tyre dhe jo e KK-së të merret me çështje të tilla. Në formën se çfarë është propozuar këtu ne jemi kundër.

Arben Mehmeti- lidhur me këtë çështje edhe qëndrimi i jonë ka qenë publik që disa kohë duke filluar nga një trup e Kuvendit i cili është Komiteti për Shërbime Publike e cila trup i bie të gjitha rekomandimet të cilat kanë të bëjnë me atë komitet.

Ju e dini që ky komitet nuk e ka kaluar këtë propozim dhe është e mirë e atij komiteti, sepse është munduar ta ruaj zbatimin e ligjshmërisë.

Mirëpo presionet e më vonshme kanë ndikuar që të ndryshohet ai qëndrim, por edhe në KPF rezultati ka qenë shumë i ngushtë (4 me 5). Kjo është një sinjal që do të ndikojë shumë negativisht edhe nëse ju e merrni një vendim, ky nuk është sinjal i mirë për qytetarë, kur kemi parasysh se ky vendim është në kundërshtim me ligjin për mbeturinat, i aprovuar në Kuvendin e Kosovës e që këtë përgjegjësi nuk ia lë kuvendeve komunale.

Është i aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe është e obliguar çdo komunë për ta respektuar. Nuk parashihet një e drejtë e tillë për të bërë komuna kushtëzime në këtë formë. Sa për njoftim është në procedurë e sipër projekt- ligji për mbeturina i iniciuar prej Qeverisë së Kosovës e që do ta rregullojnë këtë fushë. Ky ligj është aktual dhe në shqyrtim.

Po ashtu është në kundërshtim me rregulloren 2004/29 mbi Veprimtarit e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave, e cila është në fuqi derisa nuk rregullohet me ligje të tjera. Tek këto kompani është përgjegjëse Zyra e rregullatorit për ujë dhe mbeturina dhe këtu janë të parapara të drejtat e kompanisë dhe Komunës.

Në bazë të kësaj që e thash në këtu kemi të bëjmë me shkeljen e disa ligjeve, prandaj edhe unë kërkoj që kjo çështje të shtyhet dhe ta shohim se çfarë vendimi do të merr Kuvendi i Kosovës. Me zyrën konsumatorit parashihet se çka është konsumatori, çka është kontrata e shërbimit të cilat mungojnë aktualisht. Unë nuk e di cili prej neve e ka të nënshkruar një kontratë me Kompaninë “Higjiena” me kompaninë “Hidroteknika” dhe aty kemi të bëjmë me një lloj anarkie dhe nuk ka zbatim të ligjit. Për të mos ra edhe në një konflikt me ligjin është mirë të shtyhet kjo çështje, të debatohet dhe të vazhdojmë më tutje.

Arben Maliqi- unë do ta jap opinionin tim në emër timin dhe të grupit dhe e them këtë me plotë zemër dhe plotë gojë. Jemi një Kuvendi në të cilin vendimet 90% i kemi marrë me koncenues. Kemi gjet gjuhë të përbashkët, por kësaj radhe po e shoh se këtu nuk ka koncenues, opozita nuk është në pajtim. Unë kërkoj nga të gjithë që ta përfundojmë mandatin ashtu siç na ka hije, jemi një Kuvend që na ka lakmi e tërë Republika e Kosovës. Unë kërkoj 5 minuta pushim të ulemi të bisedojmë shefat e grupeve, sepse nuk është asgjë e keqe nëse shtyhet dhe mund ta gjejmë një alternativë më të mirë, sepse kushtëzimet nuk janë të mira, por unë i shoh disa njerëz që kanë mundësi për të bërë ato pagesa dhe nuk janë ata që i takojnë asaj kategorie, janë njerëz të cilët mund t bëjnë pagesën. Për hir të ruajtjes së unitetit unë kërkoj 5 minuta pushim për të biseduar shefat e grupeve për të marrë një vendim se çka më tutje.

Qemajl Mustafa- tek ky aspekt qasja që nga fillimi ka qenë politike, përveç atyre që e bartin përgjegjësinë dhe udhëheqin Komunën. Unë i lus grupet politike në opozitë që të rezonojnë ndryshe. Përfitimet e juaja janë momentale politike ndaj qytetarëve të Kosovës, por po iu siguroj në pak muajt që vijnë përfitime të mëdha politike ka me pas ky grupi që po insiston në ato kufizime. Efekti që krijohet me akumulim të atyre borxheve, është fjala për borxhe, nuk po detyrohet qytetari për të paguar avans, ne po kërkojmë vetëm 40% nga shuma e borxhit të mbledhur me vite.

Të gjitha këto fonde do të kthehen në investime në këto dy kompani.

Qe sa ka filluar humanizimi i lokacionit për “Higjienën”, ata nuk po mund të dislokohen për shkak se nuk kanë fuqi për t’ u dislokuar dhe prapë do të vijmë në situatë që Komuna prej mjeteve të veta nga taksa pagesit në pronë t’ iu ndihmojë. Iu lus për një rezon pak më të thellë dhe një përkrahje, sepse qëndrimi për mos t’ ia marrin qytetarit borxhin për ujë dhe mbeturina është kundër të ardhmes së tij. Është kundër ambientit të pastër dhe është kundër furnizimit kualitativ me ujë. Sa i përket ligjit, absolutisht, askund nuk ka shkelje të ligjit. Nëse në ligj thuhet saktë se KK- nuk ka të drejtë ta bëjë këtë, del se ka të drejtë ta rregullojë këtë çështje.

Ne e kemi një letër në dokumentacion i cilit thotë nuk ka asnjë pengesë ligjore për vendosjen e kufizimeve nga anë e KK-së.

Unë iu lus që ta përkrahni një iniciativë të tillë dhe ky KK, është sovrani dhe nëse diçka nuk funksionon në jemi këtu prapë dhe e kthejmë çështjen.

Nëse dëshiron dikush me një arsye për ta kthyer një çështje në Kuvend e kthejmë e diskutojmë, ne jemi ata që po vendosim, ne jemi ata të cilët edhe mund të heqim dorë nga ky vendim.

Zijadin Maliqi- unë jam edhe anëtarë i Komitetit për Shërbime Publike, në të cilin komitet e kemi pasur në rend të ditës këtë çështjet, të cilën e kemi refuzuar me shumicë të votave. Gjithashtu edhe grupi i këshilltarëve të LDD-së është kundër një vendimi të tillë, sepse unë e kam thënë edhe në seancën e kaluar se nga ndërmarrjet publike ne si KK, jemi të respektuar vetëm kur iu duhemi atyre! Ne në seancën e kaluar e hoqëm nga rendi i ditës një informatë të KEK-ut, sepse nuk ishte i pranishëm përfaqësuesi i KEK-ut dhe të cilët ka në deklaruar se kjo kompani i përgjigjet nivelit qendror.

Unë këtë po e arsyetoj se ne nuk kemi ndonjë informatë nga kompanitë publike, për të cilin rast “Hidromorava” ndoshta ka arsye, por KRM “Higjiena” me ligj është e obliguar për të dhënë informatë para Kuvendit për punën e saj. Një informatë që iu është dhënë nga “Higjiena”, unë i pata shtruar disa çështje të aspektit financiar për të cilin rast edhe në proces është e evidentuar, ku drejtori i kompanisë ku ka thënë: “Zijadin Maliqi pati vërejtje në sektorin financiar, por për këto do të përgjigjem në seancën e radhës”. Që nga ajo ditë ne më nuk jemi informuar.

Ne nuk e dimë gjendjen e saj, unë e kam parë një informatë që e ka dhënë komisioni për vlerësim të aseteve ku thuhet se më 2008 është bërë shlyerje e borxheve prej mbi 515 mijë euro, në 2009 prej mbi 533 mijë eurove. Shtrohet pyetje si është bërë ajo shlyerje e borxheve? Kush ka marrë vendim për shlyerje të borxheve? Kjo mënyrë e shlyerjes së borxheve i dekuaron edhe pagesit e rregullt, sepse do të thuhet nuk ka nevojë të bëhet pagesa, sepse ato po i shlyeka Komuna, apo vet kompania!

Nuk kemi informacione, ne e dimë se edhe me Statut të Komunës në nenin 108, ku thotë ndërmarrjet publike edhe buxhetin duhet ta aprovonë në KK. Unë nuk jam për mos t’ i ndihmuar, duhet t’ i ndihmojmë, por nga regjistri i Hidromoravës kam parë emra shumë të fortë të cilët nuk i kryejnë obligimet. Këto kompani fare nuk na informojnë neve dhe nuk e dimë gjendjen e tyre për këtë arsye jemi kundër!

Edhe një çështje po e theksoj se për mua ka njerëz shumë të interesuar për ta ditur a i kam kryer obligimet, apo jo! Mirëpo këtë mund ta dinë lehtë dhe të shikojnë në emër të babait tim Faik Maliqi, sepse faturat ende më vijnë në emër të babait!

Rashit Sahiti- Unë e kam një propozim që Kompani “Hidromorava” dhe “Higjiena” t’ i larojnë inkasantët, t’ i shkarkojnë drejtorët dhe ne t’ ia kryejmë punën e inkasantëve.

Unë po iu informoj shumë saktë se ka mbi 10 ditë që në Malishevë, nuk rrjedh asnjë pikë uji dhe atë për një punë shumë të vogël të cilën nuk e kryen “Hidromorava”.

Nuk e lëshojnë pompën për dhjetë metra më larg për të pasur ujë! Unë personalisht e kam një defekt, kam bërë kërkesë, por ka një vit askush nuk vjen për ta eliminuar atë defekt! Mirëpo edhe pse nuk jam harxhues i ujit, përsëri jam ngarkuar me 46 euro, të cilat i kam paguar, por ky ka qenë një qëllim politik për të ma parë emrin si borxhlinj! Me këto kufizime unë mendoj se bëhet shkelje e të drejtave të njeriut, prandaj e lus Kuvendin që mos të votohet kjo, sepse ne po iu bëjmë shërbime atyre daive, kurse ata po burokratizohen dhe nuk dalin fare në terren!

Ne do ta shikojmë edhe njëherë çështjen e ujësjellësit në Malishevë, sepse ata e kanë marrë të gatshme gjendjen, sepse instalimin e kemi bërë me shoqata të huaja.

Mirëpo sa i përket mbeturinave iu lus që të gjithë ta paguani, në mënyrë që mos të kundërmojnë erërat e këqija në fshat.

Bahrie Veseli- u dhanë shumë vërejte, por unë po theksoj se nëse ne e bëjmë një kushtëzim të tillë, kjo me të vërtetë është shkelje e të drejtave të njeriut. Mirëpo së pari po theksoj se në lagjen time, asnjëherë ditën nuk kemi ujë! A nuk është kjo një shkelje elementare e të drejtës së qytetarëve? E dyta tash të bëjmë edhe kushtëzime me pagesa, fare nuk është e drejtë! E treta a po funksionon në tërë Kosovën ligjshmëria, sepse përfaqësuesin e komunitetit serb nuk e kemi fare! Ai i paguajnë ky komunitet obligimet e tjera, të cilët edhe favorizohen në gjitha aspektet ?

Unë kam propozim konkret që qytetarët t' i vetëdisojmë në një mënyrë tjetër për t' i shlyer obligimet e tyre, por jo në këtë formë!

Unë nuk e kam për përfitime politike, por kur është fjala për mbrojtjen e qytetarit duhet të jemi të vëmendshëm.

Mimozë Kadriu- u thanë shumë gjëra, por unë desha ta them një fakt, e ai është se nuk e di pse debatohet për një çështje e cila nuk kaluar as në Komitetin për Shërbime Publike, as në Komitetin për Politikë dhe Financa. (Ishte ndërhyra e kryesuesit se në KPF, ka kaluar). Në vijim znj Kadriu theksoi se në këto kompani kanë mundësi të tjera për t' i grumbulluar obligimet e veta duke bërë ndonjë shkyçje ose të mos shkojnë për t' i marrë mbeturinat e jo të kushtëzohen në këtë mënyrë duke i kushtëzuar me nxjerrje të ndonjë dokumenti zyrtar, kur dihet se çfarë të ardhura kanë qytetarët tanë, por kushtëzimi është edhe shkelje elementare e të drejtave të njeriut.

Riad Rashiti- këtu po thuhet shkelje e të drejtave të njeriut, por unë këtu e kam një rregullore dhe këtu nuk thuhet askund se me këtë rast ka shkelje të drejtave të njeriut.

Sa i përket ligjshmërisë për kushtëzimi të pagesave, unë e kam një ligj 2003/8 mbi vendosjen tatimit në pronë pika 10.d. të cilin ligj z. Rashiti e lexon.

Sa i përket atë që e tha Rashiti, unë pajtohem plotësisht, sepse vërtetë në Malishevë ka shumë pengesa dhe që nga fillimi nuk jemi të kënaqur, sepse prej fillimit ka pasur pengesa rrjeti i ujësjellësit. Mirëpo në Malishevë ka edhe keqpërdorime, si lidhje ilegale, mospagesë të borxheve dhe pajtohem se në Malishevë është një gjendje jo e mirë. Kur u bë fjalë për Komitetin për Shërbime Publike, arsyeja e vetme pse e ka refuzuar ky komitet është se disa prej anëtarëve kanë pasur obligime ndaj Hidromoravës.

Këtu po flitet për keq menaxhim të kompanisë, por për të përmirësuar gjendjen ne duhet t' i ndihmojmë dhe nëse pas një periudhe kohore nuk ndryshon gjendja ne mund ta rishqyrtojmë këtë vendim.

Unë kam informata se Hidromoravës qytetarët i kanë borxh 2.2 milion euro, kurse Higjienës 1.2 milion, prandaj unë propozoj që të mbështet ky kushtëzim, sepse nuk ka mekanizëm tjetër për t' i realizuar këto pagesa.

Ne po tentojmë që t' i mbrojmë disa "intelektual" dhe borxhlinj të mëdhenj të cilët nuk kanë paguar me vite, prandaj ne nuk duhet të biem pre e mbrojtjes së disa politikanëve dhe intelektualëve për arsye politike.

Në fund kërkoj që ne pasi ta marrim vendimin si KK dhe kryesuesit i Kuvendit t' i drejtohen edhe komunave përkatëse si Vitia, Dardana që edhe ata të bëjnë një veprim të tillë !

Elisah Ymeri- unë fillimisht e përshëndes këtë nismë dhe mendoj se është shumë e mbarë, sepse vetëm njerëzit e papërgjegjshëm do të dëshironin për ta shfrytëzuar ujin ose t' i merr dikush mbeturinat para derës e mos ta bëjnë pagesën.

Unë askund në botë nuk kam dëgjuar se duhet hapur qezmen për të pirë ujë dhe pastruar shtëpinë dhe mos të bëhet pagesa! Kjo po ndodh vetëm tek ne dhe e vetmja formë për t' i grumbulluar borxhet është kushtëzimi.

Unë i pash disa emra dhe vërtetova se ka njerëz të cilët i kanë nga dy-tri shtëpi dhe nuk e bëjnë pagesën e tillë, ku ka më turp?

Unë nuk e kam të qartë pse mos të kushtëzohen këta njerëz? Unë nuk po e shoh këtu asnjë njeri të ndërgjegjshëm i cili ka rrogën 200-300 ero, nuk ka asnjë arsimtarë, por po shoh njerëz të cilët kanë para dhe nuk bëjnë pagesën!

E vetmja formë për t' i grumbulluar borxhet është kushtëzimi.

Sa i përket çështjes që nuk ka kaluar nëpër komitete është se në komitete ka më tepër njerëz politik se sa profesional të cilët nuk kanë mundur ta akceptojnë mirë çështjen e këtyre dy kompanive dhe zgjidhjen e daljes nga kriza të këtyre dy kompanive.

Unë bëj thirrje që ta mbështesim këtë nismë, sepse është shumë e mbarë dhe e mirë dhe është shpëtim për këto kompani, por në një formë ne edhe i vetëdijesojmë qytetarët, sepse për vetëdijesim e vetmja formë është kjo.

Duhet kushtëzim për atë që është shpenzuar, për mbeturinat që janë hedhur pra dyerve.

Kjo nuk është shkelje e të drejtave të njeriut, por është ofrimi shërbimeve për ato që po bëjnë qytetarët.

Unë iu bëj thirrje për ta mbështet këtë nismë, sepse është shumë e mbarë, por kam një kërkesë nga Hidromorava që të jetë e kujdesshme se në “Bregun e Djegur” nuk vjen uji nga dy ditë të cilin rast e theksoi edhe znj. Bahrie.

Në “Bregun e Djegur” uji nuk vjen nga dy ditë.

Ejup Haziri- të nderuar kolegë, debati ishte i mirë dhe në kohë të fundit mund të them se më i këndshmi. Unë pajtohem me shumë vërejtje që u dhanë dhe nëse flasim për menaxhimin për punën e atyre kompanive të gjitha ato vërejtje qëndrojnë.

Mirëpo për asnjë çast nuk duhet të harrojmë se jemi organi më i lartë dhe jemi në sy të qytetarëve. Në momente të caktuar nëse e mbrojmë një kategori të caktuar të njerëzve për të cilët u fol dhe të cilët janë në gjendje të mirë, nganjëherë po mendoj se mos po e nxisim një proces i cili do të jetë shumë destruktivë për të ardhmen e këtyre kompanive dhe të Komunës. Këtë po e them se ne po vendosim në mbrojtje të atyre që nuk duhet t' i mbrojmë dhe po nxisim një kontra efekt të cilin e kemi pasur në enklava për afër 10 vjet dhe të cilin mezi vitin e kaluar arritëm për ta tejkaluar.

Duhet t' i ndajmë këto dy dimensione, kufizim ose kushtëzim. Kushtëzim ka qenë me Higjienën, mos t' i merren mbeturinat ashtu si po vepron KEK-u.

Unë nuk do t' i kisha thënë kushtëzim, sepse është gabim të përdoret ky termë kushtëzim. Duhet t' nxisim këta qytetarë dhe t' i thyejmë këto tema, si tabu tema që janë bërë pas luftës dhe të mendojnë njerëzit se pas një periudhe dikush do t' i shlyejnë këto borxhe. Ajo që e tha Zijadini më pëlqeu, sepse ne mund ta bëjmë një modifikim në këtë projekt rregullorë që po tentojmë për ta nxjerr. Ne mund ta rregullojmë këtë në çdo tre ose gjashtë muaj, por edhe nëse zyrtarët e këtyre dy kompanive nuk sillen mirë me qytetarët, ne në çdo moment mund ta rishikojmë dhe mund ta anulojmë vendimin të cilin do ta marrim sot. Si rregullorë edhe ne jemi për ta mbështet, të shkojmë përpara,

sepse një rregullore e tillë nuk është destruktive, por është për ta rregulluar këtë gjendje për të cilën të gjithë patëm vërejtje.

Para se të hedhim në votim kërkoj nga kryesuesi që të na japin një pushim prej 5 minutave, sepse patëm një debat të gjatë, prandaj të relaksohemi dhe të qetësohemi dhe mandej të hyjmë në procedurë të votimit.

Ramiz Ramadani- lidhur me këtë pikë u thanë shumë gjëra, por mua po më brengos ajo se në disa raste po krijohen disa opinione se dikush është kundër qytetarëve.

Unë mendoj se është koha e fundit që të ndërpritet praktika kur një materie nuk i kalon trupat profesionale të sillet në këtë formë si ka ardhur këtu!

Nëse një lëndë nuk ka kaur në komitetin i cili është profesional, mendoj se ka qenë desh të rikthehet dhe kur ta kalojë atë trup, atëherë të kalojë në Komitetin për Politikë dhe Financa, kurse në Kuvend me pak fjalë duhet aprovohet kjo.

E dyta mendoj se politikën për kufizim duhet ta bëjë ndërmarrja publike dhe jo KK.

Ata vet të vlerësojnë a është politikë e mirë kushtëzimi dhe nëse vlerësojnë se nuk duhet kryer shërbimi, mos t'i kryejnë shërbimet!

Nëse vlerësojnë se duhet pasur një qasje tjetër ta bëjnë edhe atë qasje tjetër, por opinionimi im është se menaxhmenti i të dy kompanive është i dobët.

E shikova listën me kujdes dhe një menaxhment i cili e nxjerr një listë të tillë të borxhlinjve, për mua nuk ka aftësi për të udhëhequr, sepse është një menaxhment tendencioz, nuk e kupton integritetin e personit.

Nëse Komuna e ka vullnetin e mirë ajo së pari duhet të merret me menaxhmentin, kurse kur të shteren këto mundësi atëherë të shikohen këto masa të kufizimeve.

Ibish Ibishi- sa i përket shkeljes së ligjit nuk mund të prononcohem, sepse nuk jam ekspertë i kësaj lëmie, por ne kushtëzimin që po tentojmë t' i bëjmë qytetarëve nuk e di sa është e drejtë, por ndoshta qytetarëve do t' ia bëjmë këtë kushtëzim, por si do të ia bëjmë me ato organizata të cilat kanë borxhe mbi 10 mijë euro. Unë kam informata se ka organizatë në qytet që ka borxh mbi 10 mijë euro dhe nga mospërmbushja e këtyre obligimeve është detyruar të organizojë formë tjetër të bartjes së mbeturinave. Nga kjo që po e them unë dyshoj se do të kemi mundësi t' i kushtëzojmë ndërmarrjet të cilat kanë borxhe më të mëdha se qytetarët.

E dyta unë mendoj se Hidromorava është një Kompani shërbyese e cila nuk ka të bëjë me një menaxhim të KK-së, prandaj do të ishte barrë për neve për ta marrë edhe një obligim të tillë, sepse ka edhe forma të tjera për shlyerje të borxheve.

Unë e di që disa vite më parë KEK-u e ka aplikuar një formë të kontratës me borxhlinj dhe kështu i ka shlyer borxhet dalëngadalë. Kështu duhet edhe Hidromorava të veprojë dhe të bie një vendim më të arsyeshëm.

Sokol Haziri- dua ta sqaroj opinionin tonë dhe mendoj se askush nuk duhet për t' i mos i paguar shërbimet obligative. Nuk duhet të del një apel se këto shërbime nuk duhet të paguhen. Qytetarët duhet t' i përmbushin obligimet e tyre për të gjitha shërbimet dhe atë të gjitha kompanive të cilat ofrojnë shërbime.

Mirëpo ne nuk jemi ata që kemi kompetenca dhe përgjegjësi të tilla si KK. Kjo është esenca pse në parim po e kundërshtojmë, në asnjë mënyrë nuk duhet të krijohet në opinion se AAK është për t' i mbrojt borxhlinjtë, por edhe i bëj apel nga kjo foltore të

gjithë qytetarëve që t' i kryejnë obligimet e veta, por ne nuk jemi kompetent për të marrë vendime të tilla. Kjo është çështja pse ne po e kundërshtojmë këtë vendim.

E dyta si mund të më motivon dikush kur x personi, në rrugën "Reshat Imeri, vendi i punës (kryetar i AAK-së, kjo është shaka me njerëz, kurse vendi i punës është djali tij që punon në Prishtinë. Mos të tallemi me këso letra se kjo është çështje personale e dikujt se çka bën. Në këtë aspekt iu lus edhe njëherë dhe ta bisedojmë këtë temë, të gjejmë mënyra dhe metoda për t' i ndihmuar, sepse po e them shumë hapur që nëse vazhdon Gjilani të anashkalohet me grande nga Qeveria e Kosovës, mund ta kushtëzoni edhe Bujanocin dhe Preshevën nuk do të keni asnjë lëvizje përpara.

Izmi Zeka- mua më duket se kjo pikë po shndërrohet në debat politik, por u përmend se dy kompanitë nuk kanë raportuar në Kuvend, mirëpo ato ka dhënë raport. E dini që drejtorja e Hidromravës ka qenë këtu në Kuvend, por në nëntor të vitit të kaluar ka qenë edhe drejtori i Higjienës . Por çështjen e relacionit me Hidromoravën ne e kemi të qartë të cilën do ta rregullojmë. Iu lus që mos ta politizojmë shumë këtë çështje, prandaj nuk kemi kohë të ndalemi, sepse vetëm do të humbim nëse i ndalim çështjet.

Po e përsëris se nuk mundemi me këtë profil të gypave në Gjilan edhe po të ketë ujë të mjaftueshëm, nuk mund të kemi ujë as në Pogradinë, as në fshatra të tjera. Për këtë arsye duhet shlyer borxhet, sepse të tëra ato mjete do të shkojnë në projekte.

Këto janë shërbime të qytetarëve, këto e ndihmojnë qytetarin , sepse do ta kenë ujin edhe më kualitet dhe do të jetë më cilësor.

Ju lus që mos të përmenden të drejtat e njeriut, sepse OKB, nuk merret edhe me ujin dhe higjienën.

Qemajl Mustafa- së pari dua t' i them se Komiteti për shërbime Publike, nuk ka qenë në nivel të detyrës aspak. Njëri prej anëtarëve pash ka borxh, jo shumë enormë, por ka borxh. Ai person ka qenë në konflikt të rëndë të interesit, do t'iu dërgoj imelat dhe njëres edhe tjetres palë dhe do të shihni se ndonjëri prej tyre ka qenë në konflikt të interesit. Kur ka qenë në pozitë tillë, atëherë pse ai të votojë për ?

Ai komitet nuk e ka bërë punën vet mirë, as politikisht as profesionalisht.

Sa herë që në terren nuk funksionon diçka mirë dhe nuk është propozimi profesional dhe analiza nuk ka qenë e mirë, atëherë debati kthehet në nivelin politik. Në këtë rast vendimmarrja më nuk është profesionale.

Lidhur me "Hidromoravën" qëndron se është kompani qendrore dhe asetet e saj i takojnë qeverisë, por problemi është që llogaridhënia dhe kërkesat e qytetarëve janë në Komunë. Pak kush ose askush i drejtohet qeverisë për të kërkuar ndonjë projekt për ujë, por edhe mbeturina. Mirëpo asociacioni i komunave po bënë përpjekje për ta fut relevancën edhe tek këto kompani ani pse janë qendrore. Një pjesë të anëtarëve të bordit mund ta caktojë Komuna, por edhe llogaridhënia të jetë drejtpërdrejt te Komuna dhe Qeveria. Kontratat nuk bëhen me individ, sepse ekzistojnë aktet e themelimit edhe të Higjienës edhe Hidromoravës dhe të KEK-ut. Janë lidh kontrata me institucione me kompani dhe korporata më të mëdha.

Tek tatimi në pronë në fund të vitit 2007 kemi pasur inkasim 1.8 milion euro, mirëpo një vit më vonë pasi që e kemi aplikuar kushtëzimin, ne kemi inkasuar 2.8 milion euro, do të thotë një milion më shumë. Mirëpo ngjashëm po ndodh edhe me ndërtimin, por 5-6 ndërtime i kemi në qytet të cilat e kanë shëmtuar ardhmërinë hapësinore dhe planifikuese të këtij qyteti. Kjo nuk ka ndodh më prej janarit 2008 e këndeje, por duhet të bindeni se

me pëlqim urbanistik, kur inspeksioni nuk është në nivel të detyrës, qytetari ia fillon punës dhe sa për ndërgjegje të tyre zero cent inkasohet në buxhetin e Komunës!
Ju lus të jeni koshient të gjithë ne jemi në shërbim të qytetarëve.

Jakup Bajrami- ne nganjëherë vet i komplikojmë situatat për ndonjë temë për të cilën nuk mund të gjejmë mirëkuptime dhe në bazë të asaj që u tha ne e kuptuam se ligji nuk po e kufizoka. Argumente të tjera nuk ka për të pranuar një fakt të tillë për të cilën po mendojmë se është e ngutshme dhe si Kuvend dhe më mirë nganjëherë po i bie t' i ngritim vetëm gishtat e mos të flasim fare, me siguri më lehtë kalojmë.

Këtë temë të cilën e kemi në debat nuk mund ta pranojmë, sepse propozimi i këtij kushtëzimi është i zbehtë, sepse nuk janë marrë hapat duhur për t' u bindur edhe ne edhe qytetarët se me të vërtetë gjendja është kaotike dhe KK- me masa represive nuk mund ta shpëtojë këtë ndërmarrje. Ne si grup nuk mund ta pranojmë këtë, sepse mënyra menaxheriale, përveç raporteve që janë dhënë, nuk janë marrë hapat konkrete nga organet kompetente për t' i vlerësuar ato dobësi si brendshme si të jashtme.

Janë argumentet se me të vërtetë këto janë procedura të ngutshme dhe për pa u bërë analizat e duhura në kompani dhe kjo na detyron për të mos e pranuar këtë propozim.

Arben Malqi- ne po flasim për kushtëzime, por nuk po flasim pse kemi ardhur deri në këtë masë? Pse nuk u përmend Bordi i kompanive ? Çka është ai bord dhe pse ekziston? Pse kanë ardhur problemet deri këtu?

Unë kam një obligim ndaj qytetarëve të mi dhe po theksoj se në fshatin Kosaq, nuk ka ujë, kush e ka bërë atë projekt? Pse kanë ndodh ato gjëra? Aty fare nuk ka ujë, prandaj si të dal unë para qytetarëve të mi?

Unë kërkoja nga ju 5 minuta pushim për t' u marrë vesh për disa gjëra e pastaj ta japim mendimin tonë.

Izmi Zeka- kryesuesi i mundëson 5 minuta pushim, derisa të bëhet një marrëveshje me shefat e grupeve.

Izmi Zeka – para se ta hedhim në votim, unë e kam një vërejtje atje ku thuhet se duhet të lirohen vetëm rastet sociale, kërkoj që të përfshihen në këtë kategori edhe **familjet e Dëshmorëve, Invalidëve dhe të Veteranëve të UÇK-së.**

Me këtë përfundon debati lidhur me këtë pikë, kurse kryesuesi z. Izmi Zeka propozon që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës.

Aprovohet pika 6 e rendit të punës: Propozim vendimi për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave për mbeturina dhe ujë, me 21 vota për, 18 kundër

Izmi Zeka- aprovohet ky propozim, prezent ishin 39 këshilltarë dhe u deklaruan 21 për, kurse 18 kundër

7. Propozim vendimi për lirim nga kompensimi në emër të rregullimit të tokës ndërtimore

Izmi Zeka – këtë pikë të rendit të punës në Komitetin për Politikë dhe Financa e kemi debatuar dhe kemi theksuar se kategoria 4b të cilët nuk kanë përfituar nga dëmtimet e tërmetit të lirohen nga pagesa për nxjerrje të lejeve.

Kjo ka qenë edhe më herët, por duhet ta keni të qartë se edhe tash vlen për ata të cilët nuk kanë përfituar. Por duhet ditur se ndërtimi i shtëpisë i lejohet në ato gabarite të mëparshme ashtu si pronari e ka pasur shtëpinë.

Abdyl Aliu- në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së e përshëndesim qëllimin e mirë të sponsoruesit të këtij vendimi. Mirëpo realisht duhet shikuar edhe nga prizmi i zbatimit të ligjshmërisë. Në këtë Kosovën tonë të pas luftës nuk po ndalet ajo intencë që çdo gjë ta mbështjellim me ligjshmëri, do të thotë të krijojmë bazë ligjore për secilën nevojë dhe secilën çështje. Ne si anëtarë të Kuvendit duhet ta dimë mirë këtë dhe duhet ta dimë rëndësinë e kësaj.

Kjo temë për të cilin po debatojmë është mbuluar me Ligjin për ndërtim 2004/15, përkatësisht me nenet e atij ligji 44. 1 dhe 44.2.

Neni 44.1 thotë... të cilin z. Aliu e citon, por edhe atë 44.2.

Ne e dimë se tërmeti në Gjilan ka ndodhur në prill të vitit 2002 dhe KK dhe Qeveria e ka kryer punën brenda mundësive të asaj kohe, duke iu dal në ndihmë qytetarëve aq sa kanë mundur, mirëpo prej atëherë dhe deri më 2005 ka qenë në fuqi vendimi siç është ky. Nga 2005 e këndej kjo ka pushuar dhe nuk ka qenë më në fuqi. Mirëpo gjithçka e ka fundin e vet dhe ne kemi menduar se edhe kësaj i ka ardhur fundi më 2005.

Prej 2005 e këndej nuk janë të pakta rastet të cilët janë kategorizuar nga komisioni në kategorinë 4b, kanë aplikuar për leje ndërtimi dhe kanë paguar në emër të lejes ndërtimore. A ka paraparë sponsoruesi se çka do të ndodh me ata qytetarë të cilët i kanë shtëpitë e dëmtuara në këtë kategori dhe kanë paguar prej vitit 2005 e këndej?

Sigurisht se me marrjen e këtij vendimi do të vërshojnë rastet e tilla në Komunë dhe çka do të jetë në gjendje Komuna të bëjë për ato raste?

Ne si grup i LDK-së jemi për atë që t'iu dalim në ndihmë edhe në këto forma, por nuk jemi në asnjë mënyrë për atë që t'ë bëjmë diskriminim të qytetarëve, sepse me këtë vendim një pjesë e qytetarëve diskriminohet.

Ne si LDK, do ta votojmë këtë propozim, nëse i shtohet edhe një pikë që të zgjidhet çështja e atyre të kategorisë 4b, të cilët në mungesë të këtij vendimi për atë periudhë kanë bërë pagesën.

Izmi Zeka- duhet ta dimë se vendimet, rregulloret hyjnë në fuqi ditën e miratimit dhe ato nuk vlejnë për t'iu kthyer prapa. Nëse dikush brenda asaj periudhe që po e përmend Abdyl, ne nuk kemi mundësi për t'ia kthyer parat.

Vendimi vlen prej ditës së sotme, për kategorinë 4b.

Qemajl Mustafa- vendimi duhet të jetë shumë konciz, prandaj duhet konsultuar ligjin, sepse kjo prapë vlen ku mund të jepet leje. Mos ta kuptoj dikush se tërmeti i ka dëmtuar shtëpinë dhe ka konstatuar komisioni se është e dëmtuar në 4b dhe ai person tash lehtë mund ta merr lejen. Mund të merr leje vetëm nëse në lokacionin ku është ndërtesa e vjetër, matet ai gabarit dhe mund të epet leje ndërtimore.

Te raste ku ka pasur leje paraprake është e njohur kjo punë edhe nëse ka dëmtime ose jo, nëse dëshiron për të bërë rikonstruim për pjesën e lejes së vjetër nuk paguan. Ne po flasim në baza ligjore, atje ku lejohet, atje ku nuk lejohet nuk mund të ndërtohet edhe pse e ka shtëpinë e dëmtuar në 4b. Me këtë ne po deklarohejmë se atje ku nuk shkelet ligji e që është konstatuar se shtëpia ka qenë e dëmtuar në 4 b dhe që nuk ka marrë ndihmë nga KK, atë leje me ia dhënë.

Me këtë përfundoi debati për këtë pikë, kurse kryesuesi e propozon për ta aprovuar?

Aprovohet me 28 vota të anëtarëve të Kuvendit pika 7 e rendit të punës : Propozim vendimi për lirim nga kompensimi në emër të rregullimit të tokës ndërtimore

8. Deklarata për mbështetje të Ramush Haradinajt

Izmi Zeka- këtu para jush është deklarata në mbështetje të Ramush Haradinajt, të cilën jemi munduar për ta modifikuar ashtu si u morëm vesh në Komitetin për Politikë dhe Financa, prandaj nëse ka dikush vërejtje ne e përmirësojmë dhe e dërgojmë.

Arzie Nuhiu- jam e bindur se për këtë rast nuk do të kemi mendime për dhe kundër, por nuk do të ndalem as në përmbajtje, sepse ajo përmbajtje është e kompletuar dhe me fakte që gjykimi i z. Ramush Haradinajt dhe z. Fatmir Limaj janë të padrejta.

Unë do të ndalem vetëm te një aspekt teknik, në fillim të kësaj deklarate aty ku shkruan, Republika e Kosovës të jetë edhe KK- i Gjilanit.

Kryesuesi propozon që të aprovohet kjo deklaratë

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit deklarata për mbështetje të Ramush Haradinajt dhe Fatmir Limaj

Të ndryshme

Riad Rashiti- unë i kam dy çështje për këtë pikë. Së pari dëshiroj për ta ditur a është gjuha e parë zyrtare gjuha shqipe, sepse unë po e shoh se te mbishkrimi i kryetarit së pari është gjuha serbe, pastaj shqipe dhe kërkoj që ky gabim të përmirësohet.

E dyta është ajo që anëtarët e komisionit të Higjienës ka 6 muaj të cilët nuk janë kompensuar, prandaj duhet gjetur një mënyrë për ta bërë këtë kompensim.

Tahir Arifi- unë desh t'iu përkujtoj se ne sot shpallëm qytetar nderi të Gjilanit Beqir Musliun, por ju sot e keni obligim që sot të jeni në Sallën e Teatrit në ora 17 ku ndahet çmimi letrar Beqir Muslu.

Sokol Haziri- çështjen të cilën dua ta ngris unë, është një çështje e cila do të duhej të përcillet përmes kryetarit ose KK-s-së në instanca më të larta. Është shqetësimi i banorëve të Komunës së Parteshit për bartjen e selisë së Komunës së Parteshit në Pasjan. Për këtë dikush mendon se këtë nuk duhet diskutuar, por unë e di se kryetari pat kërkuar që të jetë për një kohë si zv/kryetar për komunitet në Gjilan, kurse ai tash e bartë selinë prej Parteshit në Pasjan. Gjilani duhet ta ngris zërin dhe

plani i Ahtisarit për asnjë shkronjë nuk guxon të ndryshohet. Unë jam takuar me banorët e Parteshit dhe ata kanë kërkuar që në KK- të Gjilanit ta shqyrtojmë këtë çështje.

Duhet të merremi më seriozisht me këtë çështje, sepse nuk e ka këtë drejtë askush për ta ndërruar selinë e komunës, prandaj z. zv/ministër ju duhet ta ngritni këtë çështje në nivel të qeverisë.

Rashit Sahiti- sot me dëshirë kam ardhur në Kuvend, sepse kam qenë i bindur se do të na i sillini llap-topët të cilët na i keni premtuar.

Gjithashtu kryetari i Komunës ka deklaruar se do ta bëjmë një vizitë në Shqipëri dhe dot vizitojmë një komunë, por edhe kjo kërkesë nuk po realizohet!

Ju lutem edhe kryetarit dhe kryesuesit që realizoni këto premtime të cila ti keni dhënë vet?

Qemajl Mustafa- unë jam informuar nga Zyra e prokurimit se llap-topët kanë ardhur, mirëpo AIT-a është duke e bërë një rishikim teknik për të parë a është pajisja konformë ofertës.

Sa i përket marrëveshjes për në Shqipëri, unë kam bërë një marrëveshje preliminare me kryetarin e Komunës së Fierit i cili na pret me shumë kënaqësi, por atje është komplikuar situata me zgjedhje.

Riad Rashiti- do të kisha dëshiruar që komisioni i cili është themeluar për Këshilla të fshatrave ta japin një informatë në seancën e shtatorit.

Izmi Zeka- kam një kërkesë që mos të nënshkruhen në lista për njëri tjetrin, sepse ko po ndodh!

Me këtë përfundoi punimet seanca e Kuvendit në ora 13.50 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA